



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:060389

Datë: 16.07.2024

Numri i dokumentit: 05946064

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Driton Sadiku, me sekretaren juridike Mandushe Doli, në çështjen penale ndaj të pandehurit U.D., nga Gjakova, rr....., të cilin me autorizim e mbron av.Korab Bokshi nga Gjakova, për shkak të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në vazhdim KPRK-së) dhe kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1572/2023 të datës 21.02.2024, duke vendosur për marrëveshjen e ndërmjetësimit Nd.nr.55/2024 e datës 09.07.2024, jashtë seancës, me datën 16.07.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.55/2024 e datës 09.07.2024, e lidhur në mes të pandehurit U.D., nga Gjakova dhe të dëmtuarve A.D., nga Gjakova dhe F.A., , pronar i Rent a Car “...”, Sh.P.K, ashtu që;

HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1572/2023, të datës 21.02.2024 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit U.D., për shkak të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së dhe kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së, pasi që palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, në këtë gjykatë ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1572/2023, të datës 21.02.2024, ndaj të pandehurit U.D., për shkak të veprës penale asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 321 par.1 të KPRK-së dhe kanosja nga neni 181 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datën 20.06.2024 në të cilën seancë kanë marrë pjesë prokurorja e shtetit Uridia Caka, i pandehuri U.D., dhe mbrojtësi i tij av.Korab Bokshi, e dëmtuara A.D., ku pas leximit të aktakuzës gjykata i njoftoj palët lidhur me mundësin e zgjidhjes së kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, ashtu që i pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë propozuar që kjo çështje të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, po ashtu me këtë propozim u pajtua edhe e dëmtuara A.D., si dhe prokurorja e shtetit, po ashtu meqenëse përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarës”, nuk ishte prezent, i njëjti në praninë e gjitha palëve u kontaktua në telefon nga sekretarja juridike e gjykatës, ku dha pëlqimin që kjo çështje të referohet në ndërmjetësim, për çka gjykata aprovoj propozimin e tyre dhe këtë çështje penale e referoj në procedurën e ndërmjetësimit.

Me datën 09.07.2024, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në prezencën e ndërmjetësueses N.D., palët kanë arritur marrëveshje për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, duke deklaruar se e kuptojnë procedurën e ndërmjetësimit dhe vullnetarisht pajtohen që ta fillojnë këtë procedurë, pajtohen që të përmbahen nga ndonjë veprim tjetër juridik gjatë procedurës së ndërmjetësimit, janë informuar dhe i pranojnë shpenzimet e procedurës, përfshirë tarifën e ndërmjetësimit.

Po ashtu në të njëjtën ditë në mes të palëve është arritur edhe marrëveshja për zgjidhjen e kësaj çështje penale në procedurën e ndërmjetësimit, ku i pandehuri U.D. ka pranuar me keqardhje ngjarjen e ndodhur dhe ka deklaruar se ka kryer të gjitha obligimet që rrjedhin nga kjo vepër ndaj palëve të dëmtuara. Të dëmtuarit A.D., dhe F.A., pranon i të dëmtuarës”, kanë deklaruar se e marrin në konsideratë faljen dhe keqardhjen e shprehur nga i pandehuri dhe njëherit pranojnë që të gjitha obligimet të cilat kanë rrjedhur nga rasti i ndodhur janë kryer dhe se rasti i tillë të mbyllet duke u tërhequr nga ndjekja penale, duke pranuar që kjo marrëveshje të konsiderohet si tërheqje nga ndonjë kompensim eventual.

Gjykata duke parasysh që palët kanë arritur marrëveshjen në procedurën e ndërmjetësimit, pas vlerësimit të marrëveshjes, duke vepruar në bazë të dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që vlerësoj se e njëjta është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi, e cila marrëveshje në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësimin, do të ketë fuqinë e dokumentit përmbarues nga data e aprovimit nga gjykata.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës është marr në bazë të nenit 453 par.1 të KPP-së

Gjykata duke u bazuar nga të cekurat si më lartë dhe në bazë të nenin 357 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së dhe nenit 11 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

2024:060389, me datën 16.07.2024

Sekretarja juridike,
Mandushe Doli

Gjyqtari,
Driton Sadiku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej tre (3) ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.